

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 4

Kontratat e Sigurimit

Objektivi

- 1 Objektivi i këtij SNRF është të specifikojë raportimin financiar për *kontratat e sigurimit nga cdo njësi ekonomike që lëshon kontrata të tilla (përkrahur në këtë SNRF si një sigures)* derisa Bordi të plotësojë fazën e dytë të projektit të tij mbi kontratat e sigurimit. Veçanërisht ky SNRF kërkon:
- (a) përmirësime të kufizuara të kontabilitetit nga siguresit për kontratat e sigurimit.
 - (b) dhënie informacionesh shpjeguese, të cilat identifikojnë dhe shpjegojnë shumat në pasqyrat financiare të siguresit, të cilat rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe ndihmojnë përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare të kuptojnë shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare nga kontratat e sigurimit.

Objekti

- 2 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard për:
- (a) kontratat e sigurimit (përfshirë *kontratat e risigurimit*) që ajo lëshon dhe kontratat e risigurimit që ajo mban.
 - (b) instrumentat financiarë që ajo emeton me një *tipar pjesmarrjeje të lirë* (shih paragrafin 35). SNRF 7 *Instrumentat Financiarë: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese* kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese rreth instrumenteve financiarë, përfshirë instrumentat financiarë që përmbajnë tipare të tilla.
- 3 Ky SNRF nuk trajton aspekte të tjera të kontabilitetit nga siguresit të tilla si kontabiliteti për aktivet financiare të mbajtur nga siguresit dhe pasivet financiare të emetuara nga siguresit (shih SNK 32 *Instrumentat Financiarë: Paraqitja*, SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja* dhe SNRF 7), me përjashtim të kushteve kalimtare që jepen në paragrafin 45.
- 4 Një njësi ekonomike nuk duhet të zbatojë këtë SNRF për:
- (a) garancitë e produkteve të nxjerra direkt nga një prodhues, ndërmjetës ose shitës me pakicë (shih SNK 18 *Të Ardhurat* dhe SNK 37 *Provizionet, Pasivet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kufëzuara*).
aktivet dhe pasivet e punëdhënësit sipas skemave të përfitimeve të punonjësve (shih SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve* dhe SNRF 2 *Pagesat e bazuara në Aksione*) dhe detyrimet e përfitimit të pensionit të raportuara nga skemat e përfitimit të pensionit të përcaktuar (shih SNK 26 *Kontabiliteti dhe Raportimi për Planet e Përfitimit të Pensionit*)
 - (c) të drejtat kontraktuale ose detyrimet kontraktuale të cilat janë të kushtëzuara me përdorimin e ardhshëm ose të drejtën e përdorimit të një zëri jo-financiar (për shembull disa komisione liçencash, të drejtash shfrytëzimi, pagesa të kushtëzuara të qirasë dhe zëra të ngjashëm) si dhe vlerën e mbetur të garancisë të një qiramarrësi të përfshirë në një qira financiare (shih SNK 17 *Qiratë*, SNK 18 *Të Ardhurat* dhe SNK 38 *Aktivitet Jo-Materiale*).
 - (d) kontratat e garancisë financiare vetëm nëse lëshuesi ka pohuar më parë në mënyrë të qartë se i sheh këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur kontabilitetin e zbatueshëm për kontratat e sigurimit, rast në të cilin lëshuesi mund të zgjedhë të zbatojë ose SNK 39, SNK 32 dhe SNRF 7 ose këtë Standard për kontrata të tilla të garancisë financiare. Lëshuesi mund të bëjë zgjedhjen kontratë për kontratë, por zgjedhja për secilën kontratë është e pakthyeshme.
 - (e) shuma e kushtëzuar e pagueshme ose e arkëtueshme në një kombinim biznesi (shih SNRF 3 *Kombinimi i Bizneseve*).
 - (f) *kontratat direkte të sigurimit* që njësi ekonomike i mban (d.m.th. kontratat direkte të sigurimit në të cilën njësi ekonomike është *mbajtësi i policës së sigurimit*). Megjithatë një *cedues* duhet të zbatojë këtë SNRF për kontratat e risiguruara që ai mban.
- 5 Për lehtësi referimi, ky SNRF përkrahur çdo njësi ekonomike që nxjerr një kontratë sigurimi si një sigures, pavarësisht nëse nxjerrësi shihet ose jo si një sigures për qëllime ligjore ose mbikëqyrjeje.
- 6 Një kontratë risigurimi është një tip kontrate sigurimi. Prandaj, të gjitha referencat në këtë SNRF për kontratat e sigurimit zbatohen edhe për kontratat e risigurimit.

Derivativët e përfshirë

- 7 SNK 39 kërkon që një njësi ekonomike të veçojë disa derivativë të përfshirë nga kontrata e tyre mbajtëse, t'i masë ata me *vlerën e drejtë* dhe të përfshijë ndryshimet në vlerën e tyre të drejtë në fitim ose humbje. SNK 39 zbatohet për derivativët e përfshirë në një kontratë sigurimi me përjashtim të rastit kur derivativi i përfshirë është në vetvete një kontratë sigurimi.
- 8 Si një përjashtim i kërkesës në SNK 39, një sigurues nuk ka nevojë të veçojë dhe matë me vlerën e drejtë një opsjon të mbajtësit të policës së sigurimit për të dorëzuar një kontratë sigurimi për një shumë fikse (ose për një shumë të bazuar në një shumë fikse dhe një normë interesi), madje edhe nëse çmimi që përdoret ndryshon nga *vlera kontabël e pasivit të sigurimit bazë*. Megjithatë, kërkesa në SNK 39 zbatohet për një kontratë me opsjon ose opsjonin e dorëzimit në mjete monetare të përfshirë në një kontratë sigurimi nëse vlera e dorëzimit ndryshon në përgjigje të ndryshimit në një variabël financiar (të tilla si një çmim ose indeks kapitali ose malli) ose një variabël jo-financiar i cili nuk është specifik për një palë të kontratës. Për më tepër, kjo kërkesë zbatohet edhe nëse aftësia e mbajtësit të policës së sigurimit për të përdorur një kontratë me opsjon ose opsjon të dorëzimit në mjete monetare buron nga një ndryshim në një variabël të tillë (për shembull, një kontratë me opsjon që mund të ushtrohet nëse një indeks i tregut të aksioneve arrin një nivel të caktuar).
- 9 Paragrafi 8 zbatohet njëjloj për opsjonet e dorëzimit të një instrumenti financiar që ka tiparin e pjesmarrjes së lirë.

Veçimi i përbërësve të depozitës

- 10 Disa kontrata sigurimi përmbajnë edhe një përbërës sigurimi ashtu edhe një *përbërës depozite*. Në disa raste një siguruesi i kërkohet ose i lejohet të *veçojë* këta përbërës:
- (a) veçimi kërkohet nëse plotësohen njëkohësisht kushtet vijuese:
 - (i) siguruesi mund të matë përbërësin e depozitës (përfshirë çdo opsjon dorëzimi të përfshirë) veças (d.m.th. pa marë në konsideratë përbërësin e sigurimit).
 - (ii) politikat kontabël të siguruesit nuk kërkojnë që ai të njohë të gjithë detyrimet dhe të drejtat që vijnë nga përbërësit e depozitës.
 - (b) veçimi lejohet, por nuk kërkohet, nëse siguruesi mund të matë përbërësin e depozitës veças si në (a)(i) por politikat kontabël të tij kërkojnë që të njohë të gjitha detyrimet dhe të drejtat që vijnë nga përbërësi i depozitës, pavarësisht nga baza e përdorur për të matur këto të drejta dhe detyrime.
 - (c) veçimi ndalohet nëse një sigurues nuk mund të matë përbërësin e depozitës veças si në (a)(i).
- 11 Në vijim jepet një shembull i një rasti kur politikat kontabël të një siguruesi nuk kërkojnë që ai të njohë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga një përbërës i depozitës. Një cedues merr kompensim për humbjet nga një *risigurues*, por kontrata detyron që ceduesi të shlyejë kompensimin në vitet e ardhshme. Ky detyrim rrjedh nga një përbërës i depozitës. Veçimi kërkohet kur politikat kontabël të ceduesit do të lejonin që ai të njohë kompensimin si të ardhur pa njohur detyrimin që rezulton.
- 12 Për të veçuar një kontratë, një sigurues duhet të:
- (a) zbatojë këtë SNRF për përbërësin e sigurimit.
 - (b) zbatojë SNK 39 për përbërësin e depozitës.

Njohja dhe Matja

Përjashtimi i përkohshëm nga disa SNRF të tjera

- 13 Paragrafët 10-12 të SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet* specifikon kriterin që përdor një njësi ekonomike në zhvillimin e një politike kontabël kur asnjë SNRF nuk zbatohet në mënyrë specifike për një zë të caktuar. Megjithatë, ky SNRF përjashton një sigurues nga zbatimi i atyre kriterëve për politikat e tij kontabël për:
- (a) kontratat e sigurimit që ai lëshon (përfshirë kostot respektive të blerjes dhe aktivet jomateriale respektive, të tilla si ato të përshkruara në paragrafët 31 dhe 32); dhe
 - (b) kontratat e risigurimit që ai mban.
- 14 Megjithatë ky SNRF nuk përjashton një sigurues nga disa pasoja të kriterëve të dhëna në paragrafët 10-12 të SNK 8. Në mënyrë specifike një sigurues:

- (a) nuk duhet të njohë si pasiv asnjë provizion për kërkesa të mundshme të ardhshme, nëse këto kërkesa vijnë nga kontrata sigurimi të cilat nuk ekzistojnë në datën e raportimit (të tilla si provizionet për katastrofa dhe provizionet për balancim).
- (b) duhet të kryejë *testin e mjaftueshmërisë së pasivit* të përshkruar në paragrafët 15-19.
- (c) duhet të heqë një pasiv të sigurimit (ose një pjesë e një pasivi të sigurimit) nga bilanci kontabël i tij në qoftë se dhe vetëm në qoftë se, ai është shuar-d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë çregjistrohet ose fshihet ose skadon.
- (d) nuk duhet të kompensojë:
 - (i) *aktivet e risigurimit* kundrejt pasiveve respektive të sigurimit; ose
 - (ii) të ardhurat ose shpenzimet nga kontratat e risigurimit kundrejt shpenzimeve ose të ardhurave nga kontratat respektive të sigurimit.
- (e) duhet të marrë në konsideratë faktin nëse aktivet e tij të risigurimit janë zhvlerësuar (shih paragrafin 20).

Testi i mjaftueshmërisë së pasiveve

- 15 Një sigures duhet të vlerësojë në çdo datë raportimi nëse pasivet e tij të njohura të sigurimit janë të mjaftueshme, duke përdorur vlerësime aktuale të flukseve të ardhshme të mjeteve monetare sipas kontratave të tij të sigurimit. Nëse ky vlerësim tregon se vlera kontabël e pasiveve të tij të sigurimit (minus kostot respektive të shtyra të blerjes dhe aktivet respektive jomateriale, të tilla si ato të trajtuara në paragrafët 31 dhe 32) është e pamjaftueshme duke marrë parasysh flukset e ardhshme të mjeteve monetare, i gjithë mungesa (pamjaftueshmëria) duhet të njihet në fitim ose humbje.
- 16 Nëse një sigures zbaton një test të mjaftueshmërisë së pasiveve i cili plotëson kërkesat minimale të specifikuara, ky SNRF nuk detyron plotësimin e kërkesave të tjera. Kërkesat minimale janë si vijon:
- (a) Testi merr në konsideratë vlerësimet aktuale të të gjitha flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve të mjeteve monetare respektive të tilla si kostot e shqyrtimit të kërkesave, ashtu si dhe flukset monetare që vijnë nga opsionet e përfshirë dhe garancitë.
 - (b) Nëse testi tregon se pasivi është i pamjaftueshëm, e gjithë mungesa (pamjaftueshmëria) njihet në fitim ose humbje.
- 17 Nëse politikat kontabël të një siguresi nuk kërkojnë një test të mjaftueshmërisë së pasivit i cili plotëson kërkesat minimale të paragrafit 16, siguresi duhet të:
- (a) përcaktojë vlerën kontabël të pasiveve përkatëse të sigurimit¹ minus vlerën kontabël të:
 - (i) çdo kostoje respektive të shtyrë të blerjes; dhe
 - (ii) çdo aktivi jo-material respektiv, të tilla si ato të blera në një kombinim biznesi ose transferim portofoli (shih paragrafët 31 dhe 31). Megjithatë aktivet respektive të risigurimit nuk merren në konsideratë sepse një siguresi i trajton ato veças (shih paragrafin 20).
 - (b) përcaktojë nëse shuma e përshkruar në (a) është më e vogël se vlera kontabël që do të kërkohej nëse pasivet përkatëse të sigurimit do të ishin brenda objektit të SNK 37. Nëse është më e vogël, siguresi duhet të njohë të gjithë diferencën në fitim ose në humbje dhe të pakësojë vlerën kontabël të kostove respektive të shtyra të blerjes ose aktiveve jo-materiale respektive, ose të rrisë vlerën kontabël të pasiveve kryesore të sigurimit.
- 18 Nëse testi i mjaftueshmërisë së pasiveve të një siguresi plotëson kërkesat minimale të paragrafit 16, testi zbatohet në nivelin e bashkimit të specifikuar për atë test. Nëse testi i tij i mjaftueshmërisë së pasiveve nuk plotëson kërkesat minimale, krahasimi i përshkruar në paragrafin 17 duhet të bëhet në nivelin e një portofoli kontratash, të cilat janë subjekt i rreziqeve mjaft të ngjashme dhe menaxhohen së bashku si një portofol i vetëm.
- 19 Shuma e përshkruar në paragrafin 17(b) (d.m.th. rezultati i zbatimit të SNK 37) duhet të pasqyrojë marzhet e ardhshme të investimit (shih paragrafët 27-29) në qoftë se dhe vetëm në qoftë se, shuma e përshkruar në paragrafin 17(a) gjithashtu pasqyron këto marzhe.

¹ Pasive sigurimi të përshtatshme janë ato pasive sigurimi (dhe kosto përkatëse e blerjes e shtyrë dhe aktivet përkatëse jo--materiale) për të cilat politikat kontabël të siguruiesit nuk kërkojnë kryerjen e një testi të mjaftueshmërisë së pasiveve që plotëson kërkesat minimale të paragrafit 16.

Zhvlërësimi i aktiveve të risigurimit

- 20 Nëse një aktiv i risiguar i një ceduesi është zhvlërësuar ceduesi duhet të pakësojë vlerën kontabël të tij në përputhje me rrethanat dhe të njohë këtë humbje nga zhvlërësimi në fitim ose humbje. Një aktiv i risiguar zhvlërësohet nëse dhe vetëm nëse:
- ka evidencë objektive, e cila rrjedh nga një ngjarje që ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit të risigurimit, se ceduesi mund të mos marrë të gjitha shumatat që i detyrohen atij sipas kushteve të kontratës; dhe
 - ngjarja ka një ndikim të matshëm në mënyrë të besueshme mbi shumatat që ceduesi do të marrë nga risiguresi.

Ndryshimet në politikat kontabël

- 21 Paragrafët 22-30 zbatohen si për ndryshimet e bëra nga një sigures që tashmë zbaton SNRF-të ashtu dhe për ndryshimet e bëra nga një sigures që zbaton për herë të parë SNRF-të.
- 22 **Një sigures mund të ndryshojë politikat e tij kontabël për kontratat e sigurimit nëse dhe vetëm nëse ndryshimet i bëjnë pasqyrat financiare më të përshtatshme për nevojat e vendim-marrjes së përdoruesve dhe jo më pak të besueshme, ose më të besueshme dhe jo më pak të përshtatshme për këto nevoja. Një sigures duhet të gjykojë përshtatshmërinë dhe besueshmërinë sipas kriterëve që janë dhënë në SNK 8**
- 23 Për të justifikuar politikat e tij kontabël për kontratat e sigurimit, një sigures duhet të tregojë se ndryshimi i i sjell pasqyrat e tij financiare më afër me plotësimin e kriterëve në SNK 8, por ndryshimi nuk ka nevojë që të arrijë pajtueshmëri të plotë me këto kriterë. Më poshtë janë trajtuar këto çështje specifike:
- normat aktuale të interesit (paragrafi 24);
 - vazhdimi i praktikave ekzistuese (paragrafi 25);
 - kujdesi (paragrafi 26);
 - marzhet e ardhshme të investimit (paragrafët 27-29); dhe
 - kontabiliteti hije (paragrafi 30).

Normat aktuale të interesit të tregut

- 24 Një sigures lejohet, por nuk i kërkohet, të ndryshojë politikat e tij kontabël kështu që ai i rimat pasivet e sigurimit të klasifikuara², për të reflektuar normat aktuale të interesit të tregut dhe i njeh ndryshimet në këto pasive në fitim ose humbje. Në të njëjtën kohë, ai mund të përdorë edhe politika kontabël të cilat kërkojnë vlerësime dhe supozime të tjera aktuale për pasivet e klasifikuara. Zgjedhja në këtë paragraf lejon një sigures të ndryshojë politikat e tij kontabël për pasivet e klasifikuara, pa zbatuar këto politika në mënyrë të qendrueshme për të gjitha pasivet e ngjashme siç do të kërkonte ndryshe SNK 8. Nëse një sigures përcakton pasivet për këtë zgjedhje ai duhet të vazhdojë të zbatojë normat aktuale të interesit të tregut (dhe, nëse është e zbatueshme, vlerësimet dhe supozimet e tjera aktuale) në mënyrë të qendrueshme në të gjitha periudhat për të gjitha këto pasive derisa ato të jenë shlyer.

Vazhdimi i praktikave ekzistuese

- 25 Një sigures mund të vazhdojë praktikën në vijim, por përdorimi i ndonjëris prej tyre nuk plotëson paragrafin 22:
- matjen e pasiveve të sigurimit mbi një bazë të paskontuar.
 - matjen e të drejtave kontraktuale për tarifën e menaxhimit të investimeve të ardhshme me një shumë e cila tejkalon vlerën e drejtë të tyre siç nënkuptohet nga një krahasim me tarifën aktuale që përdoren nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut për shërbime të ngjashme. Ka të ngjarë që vlera e drejtë në krijimin e këtyre të drejtave kontraktuale të barazojë kostot fillestare të paguara, me përjashtim të rastit kur komisionet e menaxhimit të investimeve të ardhshme dhe kostot e lidhura, janë jashtë linjës së të krahasueshmeve të tregut.
 - përdorimi i politikave kontabël jo-uniforme për kontratat e sigurimit (dhe kostot e shtyra të lidhura me blerjen dhe aktivet jo-materiale të lidhura, nëse ka) të filialeve, me përjashtim të sa lejohet nga paragrafi

² Në këtë paragraf, pasivet e sigurimit përfshijnë kostot e blerjes të shtyra dhe aktivet jo-materiale, sic janë ato të trajtuara në paragrafët 31 dhe 32.

24. Nëse këto politika kontabël nuk janë uniforme, një sigurues mund t'i ndryshojë ato, nëse ndryshimi nuk i bën politikat kontabël më të ndryshme dhe gjithashtu plotëson kërkesat e tjera në këtë SNRF.

Kujdesi

- 26 Një sigurues nuk ka nevojë që për të eliminuar kujdesin e tepërt, të ndryshojë politikat e tij kontabël për kontratat e sigurimit Megjithatë nëse një sigurues tashmë mat kontratat e tij të sigurimit me kujdes të mjaftueshëm, ai nuk duhet të tregojë kujdes shtesë.

Marzhet e ardhshme të investimit

- 27 Një sigurues nuk ka nevojë të ndryshojë politikat e tij kontabël për kontratat e sigurimit për të eliminuar marzhet e ardhshme të investimit. Megjithatë ka një supozim të kundërshtueshëm se pasqyrat financiare të një siguruesi do të bëhen më pak të përshtatshme dhe të besueshme, nëse ai përdor një politikë kontabël e cila pasqyron marzhet e ardhshme të investimit në matjen e kontratave të sigurimit, me përjashtim të rastit kur këto marzhe ndikojnë pagesat kontraktuale. Dy shembuj të politikave kontabël që pasqyrojnë këto marzhe janë:
- përdorimi i një normë skontimi e cila pasqyron kthimin e vlerësuar mbi aktivet e siguruesit; ose
 - projektimi i kthimeve në këto aktive me një normë të vlerësuar kthimi, duke i skontuar këto kthime të parashikuara me një normë të ndryshme dhe duke përfshirë rezultatin në matjen e pasivit.
- 28 Një sigurues mund të kapërcejë supozimin e kundërshtueshëm të përshkruar në paragrafin 27, nëse dhe vetëm nëse, përbërësit e tjerë të një ndryshimi në politikat kontabël, shtojnë përshtatshmërinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare të tij në mënyrë të mjaftueshme për të tejkaluar rënien e përshtatshmërisë dhe besueshmërisë të shkaktuar nga përfshirja e marzheve të ardhshme të investimit. Për shembull, supozoni se politikat kontabël ekzistuese të një siguruesi për kontratat e sigurimit përfshijnë supozime të tepërta kujdesi, të bëra qysh në krijim, dhe një normë skontimi të përcaktuar nga një rregullator pa referim të drejtpërdrejtë në kushtet e tregut dhe nuk marrin parasysh disa opsione të përfshira dhe garancitë. Siguruesi mund t'i bëjë pasqyrat e tij financiare më të përshtatshme dhe jo më pak të besueshme duke kaluar në një bazë kontabël më të përgjithshme të orientuar nga investitori e cila përdoret gjerësisht dhe përfshin:
- vlerësimet dhe supozimet aktuale;
 - një rregullim të arsyeshëm (por jo së tepërmi të kujdesshëm) për të pasqyruar rrezikun dhe pasigurinë;
 - matjet që pasqyrojnë si vlerën e brendshme dhe vlerën në kohë të opsioneve të përfshira dhe garancive; dhe
 - një normë skontimi aktuale të tregut, madje edhe nëse kjo normë skontimi pasqyron kthimin e vlerësuar mbi aktivet e siguruesit.
- 29 Në disa metoda matjeje, norma e skontimit përdoret për të përcaktuar vlerën aktuale të marzhit të ardhshëm të fitimit. Marzhi i fitimit më pas i ngarkohet periudhave të ndryshme duke përdorur një formulë. Në këto metoda, norma e skontimit ndikon matjen e pasivit vetëm në mënyrë indirekte. Veçanërisht përdorimi i një norme skontimi më pak të përshtatshme ka pak ose aspak efekt në matjen e pasivit në kohën e krijimit të tij. Megjithatë, në metodat e tjera, norma e skontimit përcakton matjen e pasivit në mënyrë direkte. Në rastin e fundit, për shkak se përdorimi i një norme skontimi të bazuar në aktiv ka një efekt më të rëndësishëm, ka pak mundësi që një sigurues të mund të kapërcejë supozimin e kundërshtueshëm të paragrafit 27.

Kontabiliteti hije

- 30 Në disa modele kontabël, fitimet ose humbjet e realizuara në aktivet e një siguruesi kanë një efekt direkt në matjen e disa ose të gjitha (a) pasiveve të tij të sigurimit, (b) kostove të shtyra të lidhura me blerjen dhe (c) aktiveve përkatëse jo-materiale, të tilla si ato të përshkruara në paragrafët 31 dhe 32. Një siguruesi i lejohet por nuk i kërkohet që të ndryshojë politikat e tij kontabël me qëllim që një fitim ose humbje e njohur por jo e realizuar mbi një aktiv, të ndikojë këto matje në të njëjtën mënyrë si një fitim ose humbje e realizuar. Rregullimi lidhur me pasivin e sigurimit (ose kostot e shtyra të blerjes ose aktivet jo-materiale) duhet të njihet në kapital nëse dhe vetëm nëse fitimet ose humbjet e përcaktuara njihen në mënyrë direkte në kapital. Kjo praktikë ndonjëherë përshkruhet si 'kontabiliteti hije'.

Kontratat e sigurimit të blera në një kombinim biznesi ose në një transferim portofoli

- 31 Për të plotësuar kërkesat e SNRF 3, në datën e blerjes një sigurues duhet të masë me vlerën e drejtë pasivet e sigurimit të marra dhe *aktivet e sigurimit* të blera në një kombinim biznesi. Megjithatë një siguruesi i lejohet por

nuk i kërkohet të përdorë një paraqitje të zgjeruar e cila ndan vlerën e drejtë të kontratave të sigurimit të blera në dy përbërës:

- (a) një pasiv i matur në përputhje me politikat kontabël të siguroesit për kontratat e sigurimit që ai lëshon; dhe
 - (b) një aktiv jo-material, që përfaqëson diferencën mes (i) vlerës së drejtë të të drejtave kontraktuale të sigurimit të përfuara dhe detyrimeve të sigurimit të mara dhe (ii) shumës së përshkruar në (a). Matja e mëposhme e këtij aktivi duhet të jetë e qëndrueshme me matjen e pasiveve përkatëse të sigurimit.
- 32 Një siguroes që blen një portofol të kontratave të sigurimit mund të përdorë paraqitjen e zgjeruar të përshkruar në paragrafin 31.
- 33 Aktivet jo-materiale të përshkruara në paragrafët 31 dhe 32 përjashtohen nga objekti i SNK 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve* dhe SNK 38. Megjithatë SNK 36 dhe SNK 38 zbatohen për listat e klientëve dhe marrëdhëniet e klientëve që pasqyrojnë prishmëritë për kontratat e ardhshme, të cilat nuk janë pjesë e të drejtave kontraktuale të sigurimit dhe detyrimeve kontraktuale të sigurimit, që ekzistojnë në datën e një kombinimi biznesesh ose transferimi portofoli.

Tiparet e pjesëmarrjes së lirë

Tiparet e pjesëmarrjes së lirë në kontratat e sigurimit

- 34 Disa kontrata sigurimi përmbajnë një tipar pjesëmarrjeje të lirë si edhe një *elemen të garantuar*. Lëshuesi i një kontrate të tillë:
- (a) mundet, por nuk ka nevojë, të njohë elementin e garantuar veças nga tipari i pjesëmarrjes së lirë. Nëse lëshuesi nuk i njeh ato veças, ai duhet të klasifikojë të gjithë kontratën si një pasiv. Nëse lëshuesi i klasifikon ato veçmas, ai duhet të klasifikojë elementin e garantuar si një pasiv.
 - (b) nëse njeh tiparin e pjesëmarrjes së lirë veças elementit të garantuar, duhet të klasifikojë këtë tipar ose si një pasiv ose si një përbërës të veçantë të kapitalit. Ky SNRF nuk specifikon mënyrën se si lëshuesi përcakton nëse ky tipar është një pasiv ose kapital. Lëshuesi mund të ndajë këtë tipar në përbërës të pasivit dhe kapitalit dhe duhet të përdorë një politikë kontabël të qëndrueshme për këtë ndarje. Lëshuesi nuk duhet të klasifikojë këtë tipar si një kategori të ndërmjetme, e cila nuk është as pasiv as kapital.
 - (c) mund të njohë të gjitha primet e marra si të ardhura pa veçuar ndonjë pjesë që lidhet me përbërësin e kapitalit. Ndryshimet e rezultuara në elementin e garantuar dhe në pjesën e tiparit të pjesëmarrjes së lirë të klasifikuar si një pasiv duhet të njihen në fitim ose humbje. Nëse një pjesë ose gjithë tipari i pjesëmarrjes së lirë klasifikohet në kapital, një pjesë e fitimit ose humbjes mund t'i takojë atij tipari (në të njëjtën mënyrë që një pjesë mund t'i takojë interesave të pakicës). Lëshuesi duhet të njohë pjesën e fitimit ose humbjes që i takon çdo përbërësi të kapitalit të një tipari të pjesëmarrjes së lirë, si një shpërndarje e fitimit ose humbjes, e jo si shpenzim ose e ardhur (shih SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*).
 - (d) nëse kontrata përmban një derivativ të përfshirë, i cili është brenda objektit të SNK 39, për këtë derivativ të përfshirë duhet të zbatohet SNK 39.
 - (e) për të gjitha aspektet që nuk janë përshkruar në paragrafët 14-20 dhe 34(a)-(d), duhet të vazhdojë politikat e tij kontabël ekzistuese për këto kontrata, me përjashtim të rastit kur ai ndryshon këto politika kontabël, në një mënyrë që pajtohet me paragrafët 21-30.

Tiparet e pjesëmarrjes së lirë në instrumentet financiarë

- 35 Kërkesat e paragrafit 34 zbatohen edhe për një instrument financiar që përmban një tipar pjesëmarrjeje të lirë. Veç kësaj:
- (a) nëse lëshuesi klasifikon të gjithë tiparin e pjesëmarrjes së lirë si një pasiv, ai duhet të zbatojë testin e mjaftueshmërisë së pasiveve, të paragrafëve 15-19 për të gjithë kontratën (d.m.th. si për elementin e garantuar, ashtu edhe për tiparin e pjesëmarrjes së lirë). Lëshuesi nuk ka nevojë të përcaktojë shumën që do të vijë nga zbatimi i SNK 39 për elementin e garantuar.
 - (b) nëse lëshuesi klasifikon një pjesë ose të gjithë tiparin si një përbërës të veçantë të kapitalit, pasivi i njohur për të gjithë kontratën nuk duhet të jetë më pak se shuma që do të rezultonte nga zbatimi i SNK 39 për elementin e garantuar. Kjo shumë duhet të përfshijë vlerën e perceptuar të një opsioni dorëzimi të kontratës, por nuk ka nevojë të përfshijë vlerën në kohë, nëse paragrafi 9 përjashton këtë opsion nga matja me vlerën e drejtë. Lëshuesi nuk ka nevojë të japë informacion shpjegues për shumën që do të vijë nga zbatimi i SNK 39 për elementin e garantuar dhe as ta paraqesë atë shumë veças. Për më tepër

lëshuesi nuk ka nevojë të përcaktojë këtë shumë nëse pasivet gjithsej të njohura janë qartësisht më shumë.

- (c) megjithëse këto kontrata janë instrumenta financiarë, lëshuesi mund të vazhdojë të njohë primet për këto kontrata si të ardhura, dhe rritjen që vjen në vlerën kontabël të pasivit ta njohë si një shpenzim.
- (d) megjithëse këto kontrata janë instrumenta financiarë, një lëshues që zbaton paragrafin 20(b) të SNRF 7 për kontratat me një tipar pjesëmarrjeje të lirë, duhet të japë informacion shpjegues për shpenzimet gjithsej të interesit të njohura në fitim ose humbje, por nuk ka nevojë të llogarisë këto shpenzime interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

Shpjegimi i shumave të njohura

- 36 **Një sigurues duhet të japë informacion shpjegues, që identifikon dhe shpjegon shumat në pasqyrat financiare të tij, të cilat rrjedhin nga kontratat e sigurimit.**
- 37 Për të qënë në pajtim me paragrafin 36, një sigurues duhet të japë informacion shpjegues për:
- (a) politikat e tij kontabël për kontratat e sigurimit dhe aktivet, pasivet, të ardhurat dhe shpenzimet përkatëse.
 - (b) aktivet, pasivet, të ardhurat dhe shpenzimet e njohura (dhe flukset e mjeteve monetare, nëse ai paraqet pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare me metodën direkte) që vijnë nga kontratat e sigurimit. Për më tepër nëse siguruesi është një cedues, ai duhet të japë informacione shpjeguese për:
 - (i) fitimet dhe humbjet neto të njohura në fitim ose humbje nga blerja e risigurimeve; dhe
 - (ii) nëse ceduesi shtyn dhe amortizon fitimet dhe humbjet që vijnë nga blerja e risigurimeve, amortizimin për periudhën dhe shumat e mbetura të paamortizuara në fillim dhe në fund të periudhës.
 - (c) procesin e përdorur për të përcaktuar supozimet që kanë efektin më të madh në matjen e shumave të njohura të përshkruara në (b). Kur është e mundur, një sigurues duhet të japë informacione shpjeguese sasiore rreth këtyre supozimeve.
 - (d) efektin e ndryshimeve në supozimet e përdorura për të matur aktivet e sigurimit dhe pasivet e sigurimit, duke treguar veçmas efektin e çdo ndryshimi që ka efekt material në pasqyrat financiare.
 - (e) rakordimet e ndryshimeve në pasivet e sigurimit, aktivet e risigurimit dhe nëse ka, në kostot e shtyra të lidhura me blerjen.

Natyrë dhe madhësia e rreziqeve që vijnë nga kontratat e sigurimit

- 38 **Një sigurues duhet të japë informacion shpjegues që i mundëson përdoruesit e pasqyrave të tij financiare të vlerësojnë natyrën dhe madhësinë e rreziqeve që vijnë nga kontratat e sigurimit.**
- 39 Për të qënë në pajtim me paragrafin 38, një sigurues duhet të japë informacion shpjegues për:
- (a) objektivat, politikat dhe proceset e tij për menaxhimin e rreziqeve që vijnë nga kontratat e sigurimit dhe metodat e përdorura për të manaxhuar këto rreziqe.
 - (b) [Fshirë]
 - (c) informacion rreth *rrezikut të sigurimit* (para dhe pas zbutjes së rrezikut nëpërmjet risigurimit) duke përfshirë informacion për:
 - (i) ndjeshmërinë ndaj rrezikut të sigurimit (shih paragrafin 39A).
 - (ii) përqendrimet e rrezikut të sigurimit, duke përfshirë një përshkrim të mënyrës se si drejtimi përcakton përqendrimet dhe një përshkrim të karakteristikave të përbashkëta që identifikojnë çdo përqendrim (p.sh. lloji i ngjarjes së siguruar, zona gjeografike ose monedha).
 - (iii) kërkesat aktuale të krahasuara me vlerësimet e mëparëshme (d.m.th. zhvillimin e kërkesave). Dhënia e informacioneve shpjeguese rreth zhvillimit të kërkesave duhet të kthehet në periudhën kur doli kërkesa materiale më e hershme, për të cilat ka ende pasiguri rreth shumës dhe kohës së pagesave për kërkesat, por nuk ka nevojë që të shkohet më shumë se 10 vjet pas. Një sigurues nuk ka nevojë të japë këtë informacion shpjegues për kërkesa për të cilat pasiguria rreth shumës dhe kohës së pagesave për kërkesat, zakonisht zgjidhet brenda një viti.

- (d) informacion rreth rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut, që do të kërkohej sipas paragrafëve 31-42 të SNRF 7, nëse kontratat e sigurimit do të ishin brenda objektit të SNRF 7. Megjithatë:
- (i) një sigurues nuk ka nevojë të sigurojë analizën e maturimit të kërkuar nga paragrafi 39(a) i SNRF 7, nëse në vend të saj ai jep informacion shpjegues rreth kohës së vlerësuar të flukseve dalëse të mjeteve monetare neto që vijnë nga njohja e pasiveve të sigurimit. Kjo mund të marrë formën e një analize, me afate të vlerësuar, të shumave të njohura në bilancin kontabël.
- (ii) nëse një sigurues përdor një metodë alternative për të menaxhuar ndjeshmërinë në kushtet e tregut, si p.sh., një analizë e vlerës së përfshirë, ai mund të përdorë analizën e ndjeshmërisë për të plotësuar kërkesën në paragrafin 40(a) të SNRF 7. Gjithashtu, një sigurues i tillë duhet të sigurojë dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 41 i SNRF 7.
- (e) informacion rreth ekspozimeve ndaj rrezikut të tregut që vjen nga derivativët e përfshirë që përmban një kontratë sigurimi bazë, nëse siguruesit nuk i kërkohej dhe ai nuk mat derivativët e përfshirë me vlerën e drejtë.
- 39A Për t'u pajtuar me paragrafin 39(c)(i), një sigurues duhet të japë informacion shpjegues ose për (a) ose për (b) si vijon:
- (a) një analizë ndjeshmërie e cila tregon sesi fitimi ose humbja dhe kapitali do të ndikoheshin nëse ndodhnin ndryshimet në variablat e rëndësishëm të rrezikut, të cilët ishin të mundshëm në mënyrë të arsyeshme në datën e bilancit kontabël; metodat dhe supozimet e përdorura në përgatitjen e analizës së ndjeshmërisë; dhe çdo ndryshim nga periudha e mëparëshme në metodat dhe supozimet e përdorura. Megjithatë, nëse një sigurues përdor një metodë alternative për të menaxhuar ndjeshmërinë në kushtet e tregut, si p.sh., një analizë e vlerës së përfshirë, ai mund të plotësojë këtë kërkesë duke dhënë informacione shpjeguese për këtë analizë alternative të ndjeshmërisë dhe duke dhënë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 41 i SNRF 7.
- (b) informacionin sasior rreth ndjeshmërisë dhe informacionin rreth atyre termave dhe kushteve të kontratave të sigurimit, që kanë një efekt material në shumën, afatin dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare të siguruesit.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- 40 Dispozitat kalimtare në paragrafët 41-45 zbatohen si për një njësi ekonomike që tashmë zbaton SNRF-të, kur ajo zbaton për herë të parë këtë SNRF, ashtu dhe për një njësi ekonomike që zbaton SNRF-të për herë të parë (një adoptues për herë të parë).
- 41 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 Janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF për një periudhë që fillon përpara datës 1 Janar 2005, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 41A **Kontratat e Garancisë Financiare (Ndryshimet në SNK 39 dhe SNRF 4) të publikuara në Gusht 2005, paragrafët e amenduar 4(d), B18(g) dhe B19(f). Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2006 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë njëkohësisht ndryshimet e lidhura të SNK 39 dhe SNK 32³.**

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 42 Një njësi ekonomike nuk ka nevojë të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të këtij SNRF për informacionin krahasues që lidhet me periudhat vjetore që fillojnë para datës 1 Janar 2005, me përjashtim të dhënies së informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 37(a) dhe (b) rreth politikave kontabël dhe njohjes së aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve (dhe flukset e mjeteve monetare nëse përdoret metoda direkte).
- 43 Nëse nuk është praktikë zbatimi i një kërkesë të caktuar të paragrafëve 10-35 për informacionin krahasues, i cili lidhet me periudhat vjetore që fillojnë përpara datës 1 Janar 2005, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt. Zbatimi i testit të mjaftueshmërisë së pasiveve (paragrafët 15-19) për këtë informacion

³ Kur një njësi ekonomike zbaton SNRF 7, referenca tek SNK 32 zëvendësohet nga një referencë tek SNRF 7.

krahasues ndonjëherë mund të jetë i pazbatueshëm, por ka shumë pak të ngjarë që për këtë informacion krahasues, të jetë jopraktik zbatimi i kërkesave të tjera të paragrafëve 10-35. SNK 8 shpjegon termin ‘jopraktik’.

- 44 Në zbatimin e paragrafit 39(c)(iii), një njësi ekonomike nuk ka nevojë të japë informacion shpjeguese rreth zhvillimit të kërkesave që kanë ndodhur më herët se pesë vjet nga fundi i vitit të parë financiar në të cilin ajo zbaton këtë SNRF. Për më tepër, nëse nuk është praktike, kur një njësi ekonomike zbaton për herë të parë këtë SNRF, për të përgatitur informacion rreth zhvillimit të kërkesave që kanë ndodhur më parë se fillimi i periudhës më të hershme për të cilën një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të plotë i cili përputhet me këtë SNRF, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Riklasifikimi i aktiveve financiare

- 45 Nëse një sigurues ndryshon politikat e tij kontabël për pasivet e sigurimit, atij i lejohet, por nuk i kërkohet, të riklasifikojë disa ose të gjithë aktivet financiare të tij ‘me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes’. Ky riklasifikim lejohet nëse një sigurues ndryshon politikat kontabël kur ai zbaton për herë të parë këtë SNRF dhe nëse ai bën një ndryshim të mëpasshëm të politikës së lejuar nga paragrafi 22. Riklasifikimi është një ndryshim në politikën kontabël dhe për këtë zbatohet SNK 8.

Shtojcë A

Termt e përkufizuar

Kjo shtojcë është një pjesë përbërëse e SNRF 4

Cedues	Mbajtësi i policës së sigurimit sipas një kontrate risigurimi.
përbërësi i depozitës	Një përbërës kontraktual i cili nuk trajtohet si një derivativ sipas SNK 39 dhe nëse do të ishte një instrument i veçantë, do të ishte brenda objektit të SNK 39.
kontratë direkte sigurimi	Një kontratë sigurimi që nuk është një kontratë risigurimi .
tipar i pjesëmarrjes së lirë	Një e drejtë kontraktuale për të marrë përfitime shtesë si një shtojcë e përfitimeve të garantuara : <ol style="list-style-type: none"> (a) që pritet të jenë një pjesë e rëndësishme e përfitimeve kontraktuale gjithsej; (b) shuma ose koha e të cilave, sipas kontratës varet nga nxjerrësi; dhe (c) të cilat sipas kontratës bazohen në: <ol style="list-style-type: none"> (i) performancën e një grupi të caktuar kontratash ose e një tipi të caktuar kontratash; (ii) kthimet e realizuara dhe/ose të porealizuara të investimeve në një grup të caktuar aktivesh të mbajtura nga nxjerrësi; ose (iii) fitimin ose humbjen e shoqërisë, fondit ose një njësie ekonomike tjetër që nxjerr kontratën.
vlera e drejtë	Shuma me të cilën mund të shkëmbehej një aktiv, ose mund të shlyhej një pasiv, midis palëve të vullnetëshme, të mirëinformuara dhe të palidhura me njëra-tjetrën.
kontratë e garancisë financiare	Një kontratë që i kërkon lëshuesit të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që pëson për shkak se një debitor i caktuar nuk bën pagesat kur ato kërkohen në përputhje me termt fillestare ose të modifikuara të një instrumenti borxhi.
rreziku financiar	Rreziku i një ndryshimi të mundshëm të ardhshëm në një ose më shumë norma interesi të caktuara, çmimin e instrumentit financiar, çmimin e mallit, kursin e këmbimit, indeksit të çmimeve, klasifikim kredije ose indeks kredije ose variabla të tjerë, po qe se në rastin e një variabli jo-financiar ky variabël nuk është specifik për një palë të kontratës.
përfitimet e grantuara	Pagesat ose përfitimet e tjera për të cilat një mbajtës i policës së sigurimit ose një investitor i caktuar ka një të drejtë të pakundërshtueshme e cila nuk është subjekt i zgjedhjes sipas kontratës së lëshuesit.
elementi i garantuar	Një detyrim për të paguar përfitimet e garantuara të përfshira në një kontratë që përmban një tipar pjesëmarrjeje të lirë .
aktiv i sigurimit	E drejta kontraktuale neto e një siguruesi sipas një kontrate sigurimi .
kontratë sigurimi	Një kontratë sipas të cilës një palë (siguruesi) pranon rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (mbajtësi i policës së sigurimit) duke rënë dakort që të kompensojë mbajtësin e policës së sigurimit nëse një ngjarje e caktuar e pasigurt e ardhshme (ngjarja e siguar) ndikon negativisht mbajtësin e policës së sigurimit. (Shih Shtojcën B si udhëzues për këtë përkufizim.)
pasivi i sigurimit	Detyrimi kontraktual neto i një siguruesi sipas një kontrate sigurimi .
rreziku i sigurimit	Rrezik i ndryshëm nga rreziku financiar , i transferuar nga mbajtësi i një kontrate tek lëshuesi.
ngjarja e siguar	Një ngjarje e pasigurt e ardhshme që mbulohet nga një kontratë sigurimi dhe që krijon rrezik sigurimi.
Siguruesi	Pala që ka një detyrim sipas një kontrate sigurimi për të kompensuar një mbajtës të policës së

sigurimit nëse ndodh një **ngjarje e siguar**.

testi i mjaftueshmërisë së pasiveve	Një vlerësim nëse vlera kontabël e një pasivi të sigurimit duhet të rritet (ose vlera kontabël e kostove përkatëse të shtyra të blerjes ose aktiveve përkatëse jo-materiale bie), bazuar në një shqyrtim të flukseve të ardhshme të mjeteve monetare
Mbajtësi i policës së sigurimit	Një palë që ka një të drejtë për t'u kompensuar sipas një kontrate sigurimi nëse ndodh një ngjarje e siguar .
aktivet e risigurimit	E drejta kontraktuale neto e një ceduesi sipas një kontrate risigurimi .
kontratë risigurimi	Një kontratë sigurimi e lëshuar nga një sigurues (risiguruesi) për të kompensuar një tjetër sigurues (ceduesi) për humbjet në një ose më shumë kontrata të nxjerra nga ceduesi.
Risiguruesi	Pala që ka një detyrim sipas një kontrate risigurimi për të kompensuar një cedues nëse ndodh një ngjarje e siguar .
Veçimi	Trajtimi i përbërësve të një kontrate sikur të ishin kontrata të veçanta.

Shtojcë B

Përkufizimi i një kontrate sigurimi

Kjo shtojcë është një pjesë përbërëse e SNRF 4

- B1 Kjo shtojcë jep udhëzime për përkufizimin e një kontrate sigurimi të dhënë në Shtojcën A. Ajo trajton çështjet në vijim:
- (a) termin ‘ngjarje e pasigurt e ardhshme’ (paragrafët B2-B4);
 - (b) pagesat në natyrë (paragrafët B5-B7);
 - (c) rrezikun e sigurimit dhe rreziqet e tjera (paragrafët B8-B17);
 - (d) shembuj të kontratave të sigurimit (paragrafët B18-B21);
 - (e) rrezikun e rëndësishëm të sigurimit (paragrafët B22-B28); dhe
 - (f) ndryshimet në nivelin e rrezikut të sigurimit (paragrafët B29 dhe B30).

Ngjarje e ardhshme e pasigurt

- B2 Pasiguria (ose rreziku) është thelbi i një kontrate sigurimi. Prandaj të paktën një nga çështjet e mëposhtme është e pasigurt në kohën e krijimit të një kontrate sigurimi:
- (a) fakti nëse një *ngjarje e siguruar* do të ndodhë;
 - (b) fakti nëse ajo do të ndodhë; ose
 - (c) sa duhet të paguajë siguroesi nëse ajo ndodh.
- B3 Në disa kontrata sigurimi, ngjarja e siguruar është zbulimi i një humbjeje gjatë kohës së kontratës, edhe nëse humbja vjen nga një ngjarje që ka ndodhur para fillimit të kontratës. Në kontrata sigurimi të tjera, ngjarja e siguruar është një ngjarje që ndodh gjatë kohës së kontratës, edhe nëse humbja që vjen zbulohet pas fundit të afatit të kontratës.
- B4 Disa kontrata sigurimi mbulojnë ngjarje që kanë ndodhur tashmë, por efekti financiar i të cilave është ende i pasigurt. Një shembull është një kontratë risigurimi e cila mbulon siguroesin direkt ndaj zhvillimeve negative të kërkesave tashmë të raportuara nga mbajtësit e policave të sigurimit. Në kontrata të tilla, ngjarja e siguruar është zbulimi i kostos së fundit të këtyre kërkesave.

Pagesat në natyrë

- B5 Disa kontrata sigurimi kërkojnë ose lejojnë që pagesat të bëhen në natyrë. Një shembull është kur siguroesi zëvendëson drejtpërdrejt një artikull të vjedhur, në vend të rimbursimit të mbajtësit të policës së sigurimit. Një shembull tjetër është kur një siguroes përdor spitalet dhe stafin mjekësor të tij për të dhënë shërbimet mjekësore të mbuluara nga kontratat.
- B6 Disa kontrata shërbimi me komision fiks, në të cilat niveli i shërbimit varet nga një ngjarje e pasigurt përmbushin përkufizimin e një kontrate sigurimi të dhënë në këtë SNRF, por në disa vende nuk janë rregulluar si kontrata sigurimi. Një shembull është një kontratë mirëmbajtjeje në të cilën ofruesi i shërbimit pranon të riparojë pajisjen pas një mosfunksionimi. Komisioni fiks i shërbimit bazohet në numrin e pritshëm të mosfunksionimeve, por fakti nëse një makinë e caktuar do të prishet është i pasigurt. Mosfunksionimi i pajisjes ndikon negativisht zotëruesin e saj dhe kontrata kompenson zotëruesin (në natyrë dhe jo në mjete monetare). Një tjetër shembull është një kontratë për shërbimet e riparimit të një makine në të cilën ofruesi i shërbimit pranon, kundrejt një komisioni fiks vjetor, të ofrojë ndihmën në rrugë ose të tërheqë makinën në një garazh pranë. Kontrata e fundit mund të plotësojë përkufizimin e një kontrate sigurimi edhe nëse ofruesi nuk pranon të kryejë riparime ose të zëvendësojë pjesë.
- B7 Zbatimi i SNRF për kontratat e përshkruara në paragrafin B6 ka mundësi të mos jetë më i rëndë sesa zbatimi i SNRF-ve që do të ishin të zbatueshme nëse kontrata të tilla do të ishin jashtë objektit të këtij SNRF:
- (a) Ka pak mundësi që të ketë pasive materiale për keqfunksionime dhe prishje, të cilat tashmë kanë ndodhur.
 - (b) Nëse zbatohet SNK 18 Të ardhurat, ofruesi i shërbimit do të njohë të ardhurat duke iu referuar fazës së përfundimit (dhe subjekt i kritereve të tjera të specifikuar). Kjo metodë është e pranueshme edhe sipas

këtij SNRF, i cili lejon që ofruesi i shërbimit (i) të vazhdojë politikat e tij ekzistuese kontabël për këto kontrata, me përjashtim të rastit kur ato përfshijnë praktika të ndaluara nga paragrafi 14 dhe (ii) të përmirësojë politikat e tij kontabël nëse kjo lejohet nga paragrafët 22-30.

- (c) Ofruesi i shërbimit shqyrton faktin nëse kosto e plotësimit të detyrimeve të tij kontraktuale për të dhënë shërbime tejkalon të ardhurat e marra në avancë. Për të bërë këtë, ai zbaton testin e mjaftueshmërisë së pasiveve të përshkruar në paragrafët 15-19 të këtij SNRF. Nëse ky SNRF nuk zbatohet për këto kontrata, ofruesi i shërbimit do të zbatojë SNK 37 për të përcaktuar nëse kontratat janë me kushte rënduese.
- (d) Për këto kontrata, kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese të këtij SNRF, ka pak të ngjarë të shtojnë më shumë dhënien e informacioneve të kërkuara nga SNRF-të e tjera.

Dallimi midis rrezikut të sigurimit dhe rreziqeve të tjera

- B8 Përkufizimi i një kontrate sigurimi i referohet rrezikut të sigurimit, të cilin ky SNRF e përkufizon si rrezik të ndryshëm nga *rreziku financiar*, të transferuar nga mbajtësi i një kontrate tek lëshuesi. Një kontratë që ekspozon lëshuesin ndaj rrezikut financiar pa rrezik të rëndësishëm sigurimi, nuk është një kontratë sigurimi.
- B9 Përkufizimi i rrezikut financiar në Shtojcën A përfshin një listë të variablave financiarë dhe jo-financiarë. Kjo listë përfshin variabla jo-financiarë të cilët nuk janë specifikë për një palë të kontratës, të tillë si një indeks i humbjeve nga tërmeti në një rajon të caktuar, ose një indeks i temperaturës në një qytet të caktuar. Ajo përjashton variablat jo-financiarë, që janë specifikë për një palë të një kontrate, të tilla si ndodhja ose mosndodhja e një zjarri, që dëmton ose shkatërron një aktiv të asaj pale. Për më tepër, rreziku i ndryshimeve në vlerën e drejtë të një aktivi jo-financiar nuk është një rrezik financiar, nëse vlera e drejtë pasqyron jo vetëm ndryshimet në çmimet e tregut për aktive të tilla (një variabël financiar) por gjithashtu, kushtin e një aktivi specifik jo-financiar të mbajtur nga një palë në një kontratë (një variabël jo-financiar). Për shembull, nëse një garanci e vlerës së mbetur të një veture të caktuar ekspozon garantuesin ndaj rrezikut të ndryshimit të kushteve fizike të makinës, ky rrezik është një rrezik sigurimi, jo rrezik financiar.
- B10 Disa kontrata e ekspozojnë siguruesin ndaj rrezikut financiar, përveç rrezikut të rëndësishëm të sigurimit. Për shembull, shumë kontrata sigurimi jete garantojnë një normë minimale kthimi për mbajtësit e policës së sigurimit (duke krijuar rrezik financiar) dhe premtojnë përfitime në rast vdekje, të cilat në disa raste tejkalojnë ndjeshëm tepriçën e llogarisë së mbajtësit të policës së sigurimit (duke krijuar rrezik sigurimi në formën e rrezikut të mortalitetit). Kontrata të tilla janë kontrata sigurimi.
- B11 Sipas disa kontratave, një ngjarje e siguruar synon pagesën e një shume të lidhur me një indeks çmimi. Kontrata të tilla janë kontrata sigurimi, nëse pagesa që është e kushtëzuar me ngjarjen e siguruar mund të jetë e rëndësishme. Për shembull, një pagesë vjetore nga siguruesi për sigurimin e jetës, e lidhur me një indeks të koston së jetesës, transferon rrezik sigurimi sepse pagesa synohet nga një ngjarje e pasigurt- mbijetesë e përfituesit të policës së sigurimit të jetës. Lidhja me indeksin e çmimit është një derivativ i përfshirë, por ajo gjithashtu transferon rrezik sigurimi. Nëse transferimi që rezulton i rrezikut të sigurimit është i rëndësishëm, derivativi i përfshirë plotëson përkufizimin e një kontrate sigurimi, rast në të cilin ai nuk ka nevojë të veçohet dhe të matet me vlerën e drejtë (shih paragrafin 7 të këtij SNRF).
- B12 Përkufizimi i rrezikut të sigurimit i referohet rrezikut që siguruesi pranon nga mbajtësi i policës së sigurimit. Me fjalë të tjera, rreziku i sigurimit është një rrezik para-ekzistues, i transferuar nga mbajtësi i policës së sigurimit tek siguruesi. Kështu, një rrezik i ri i krijuar nga kontrata nuk është një rrezik sigurimi.
- B13 Përkufizimi i një kontrate sigurimi i referohet një efekti negativ mbi mbajtësin e policës së sigurimit. Përkufizimi nuk e kufizon pagesën nga siguruesi të një shumë të barabartë me ndikimin financiar të ngjarjes negative. Për shembull, përkufizimi nuk përjashton mbulimin 'i ri-për- të vjetër' që paguan mbajtësi i policës së sigurimit, e cila është e mjaftueshme për të lejuar zëvendësimin e një aktivi të dëmtuar të vjetër me një aktiv të ri. Në mënyrë të ngjashme, përkufizimi nuk kufizon pagesën sipas një kontrate të sigurimit të jetës me afat, në humbjen financiare të pësuar nga personat në ngarkim të të larguarit nga jeta, dhe as nuk përjashton pagimin e shumave të parapërcaktuara për të caktuar sasinë e humbjes së shkaktuar nga vdekja ose një aksident.
- B14 Disa kontrata kërkojnë një pagesë nëse ndodh një ngjarje e pasigurt e caktuar, por nuk kërkojnë një efekt negativ mbi mbajtësin e policës së sigurimit si një parakusht për pagesën. Një kontratë e tillë nuk është kontratë sigurimi edhe nëse mbajtësi e përdor kontratën për të zbutur një ekspozim bazë ndaj rrezikut. Për shembull, nëse mbajtësi përdor një derivativ për të mbrojtur një variabël bazë jo-financiar, i cili është i lidhur me flukset e mjeteve monetare nga një aktiv i njësisë ekonomike, derivativi nuk është një kontratë sigurimi sepse pagesa nuk kushtëzohet nga fakti që mbajtësi ndikohet negativisht nga një pakësim i flukseve të mjeteve monetare nga aktivi. Anasjelltas, përkufizimi i një kontrate sigurimi i referohet një ngjarjeje të pasigurt, për të cilën një efekt negativ mbi mbajtësin e policës së sigurimit, është një parakusht kontraktual për pagesën. Parakushti kontraktual nuk kërkon që siguruesi të hetojë nëse ngjarja vërtet ka shkaktuar një efekt negativ, por i lejon siguruesit të refuzojë pagesën nëse ai nuk është i bindur se ngjarja ka shkaktuar një efekt negativ.

- B15 Rreziku i gabimit ose ngulmimit (d.m.th. rreziku që pala tjetër do të anulojë kontratën më herët ose më vonë sesa lëshuesi kishte parashikuar kur kishte caktuar çmimin e kontratës) nuk është një rrezik sigurimi, sepse pagesa ndaj palës tjetër nuk kushtëzohet nga nja ngjarje e pasigurt e ardhshme që ndikon negativisht palën tjetër. Në mënyrë të ngjashme rreziku i shpenzimit (d.m.th. rreziku i rritjes së papritur në kostot administrative të lidhura me shërbimin e një kontrate, dhe jo në kostot lidhur me ngjarjet e siguruara) nuk është rrezik sigurimi, sepse një rritje e papritur në shpenzime nuk ndikon negativisht palën tjetër.
- B16 Prandaj një kontratë që e ekspozon lëshuesin ndaj rrezikut të gabimit, rrezikut të ngulmimit ose rrezikut të shpenzimeve, nuk është një kontratë sigurimi me përjashtim të rastit kur ajo e ekspozon lëshuesin ndaj rrezikut të sigurimit. Megjithatë nëse lëshuesi i kësaj kontrate e zbut këtë rrezik duke përdorur një kontratë të dytë për transferimin e një pjesë të këtij rreziku tek një palë tjetër, kontrata e dytë e ekspozon palën tjetër ndaj rrezikut të sigurimit.
- B17 Një sigures mund të pranojë rrezik të rëndësishëm sigurimi nga mbajtësi i policës së sigurimit vetëm nëse siguresi është një njësi ekonomike e veçantë nga mbajtësi i policës së sigurimit. Në rastin e një siguresi të përbashkët, i përbashkëti pranon rrezik nga çdo mbajtës i policës së sigurimit dhe e grumbullon këtë rrezik. Megjithëse mbajtësit e policës së sigurimit mbartin këtë rrezik të grumbulluar kolektivisht në cilësinë e tyre si pronarë, i përbashkëti ende e ka pranuar rrezikun që është thelbi i një kontrate sigurimi.

Shembuj të kontratave të sigurimit

- B18 Në vijim jepen shembuj kontratash që janë kontrata sigurimi, po qe se transferimi i rrezikut të sigurimit është i rëndësishëm:
- (a) sigurimi ndaj vjedhjes ose dëmtimit të pronës.
 - (b) sigurimi ndaj detyrimit për produktin, detyrimit profesional, detyrimit civil ose shpenzimeve ligjore.
 - (c) sigurimi i jetës dhe skemat e parapagimit të funeralit (megjithëse vdekja është e sigurt, nuk është e sigurt se kur ajo do të ndodhë, ose për disa tipe sigurimi jete, nëse vdekja do të ndodhë brenda periudhës së mbuluar nga sigurimi).
 - (d) pagesat vjetore nga siguresi të lidhura me sigurimin e jetës dhe pensionet (d.m.th. kontratat që sigurojnë kompensim për ngjarjen e ardhshme të pasigurt-mbijetësën e përfituesit ose pensionistit-për të ndihmuar përfituesin ose pensionistin në mbajtjen e një standardi të caktuar jetese, i cili në kushte të tjera do të ndikohej negativisht nga mbijetesa e tij ose e saj).
 - (e) mbulimi i paaftësisë fizike dhe mjeksor.
 - (f) obligacionet e sigurta, obligacionet besnike, obligacionet e performancës dhe obligacionet ofertë (d.m.th. që sigurojnë kompensim nëse pala tjetër nuk përmbush detyrimin kontraktual, për shembull, detyrimin për ndërtimin e ndërtesës).
 - (g) sigurimi i kredisë që siguron bërjen e pagesave të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që pëson për shkak se një debitor i caktuar nuk bën pagesat kur ato kërkohen, në përputhje me termat fillestare ose të modifikuara të një instrumenti borxhi. Këto kontrata mund të kenë forma ligjore të ndryshme, të tilla si një garanci, disa tipe të letër kredisë, një kontratë kredije derivative e mospagimit ose një kontratë sigurimi. Megjithatë, ndonëse këto kontrata plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi, ato plotësojnë edhe përkufizimin e një kontrate të garancisë financiare, të dhënë në SNK 39, dhe janë brenda objektivit të SNK 32⁴ dhe SNK 39 dhe jo të këtij SNRF (shih paragrafin 4(d)). Sidoqoftë, nëse lëshuesi i kontratave të garancisë financiare ka pohuar më parë në mënyrë të qartë se i sheh këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur kontabilitetin e zbatueshëm për kontratat e sigurimit, lëshuesi mund të zgjedhë të zbatojë ose SNK 39 dhe SNK 32⁵ ose këtë Standard për kontrata të tilla të garancisë financiare.
 - (h) garancitë e produkteve. Garancitë e produkteve të lëshuara nga një palë tjetër për mallra të shitura nga një prodhues, ndërmjetës ose shitës me pakicë, janë brenda objektivit të këtij SNRF. Megjithatë garancitë e produktit të lëshuara direkt nga një prodhues, ndërmjetës ose shitës me pakicë janë jashtë objektivit të tij, sepse ato janë brenda objektivit të SNK 18 dhe SNK 37.
 - (i) sigurimi i titujve (d.m.th. sigurimi ndaj zbulimit të defekteve në tituj te tokës, të cilat nuk ishin të dukshme kur u nënshkrua kontrata e sigurimit). Në këtë rast ngjarje e siguruar është zbulimi i një defekti në titull, jo defekti në vetvete.

⁴ Kur një njësi ekonomike zbaton SNRF 7, referenca tek SNK 32 zëvendësohet nga një referencë tek SNRF 7.

⁵ Kur një njësi ekonomike zbaton SNRF 7, referenca me SNK 32 zëvendësohet nga një referencë tek SNRF 7.

- (j) ndihma në udhëtim (d.m.th. kompensimi në mjete monetare ose në natyrë për mbajtësit e policës së sigurimit për humbje të pësuar gjatë udhëtimit). Paragrafët B6 dhe B7 trajtojnë disa kontrata të kësaj natyre.
- (k) obligacionet e katastrofës, të cilat ofrojnë pagesa të zvogëluara të primit, interesit ose të të dyjave, nëse një ngjarje e caktuar ndikon negativisht lëshuesin e obligacionit (me përjashtim të rastit kur ngjarja e caktuar nuk krijon rrezik sigurimi të rëndësishëm, për shembull, nëse ngjarja është një ndryshim në një normë interesi ose në një normë të kurseve të këmbimit).
- (l) kontratat e sigurimit swaps dhe kontrata të tjera që kërkojnë një pagesë bazuar në ndryshimet në variblat klimaterikë, gjeologjikë ose varibla të tjerë fizikë, të cilat janë specifike për një palë në kontratë.
- (m) kontratat e risigurimit.

B19 Në vijim jepen shembuj të zërave që nuk janë kontrata sigurimi:

- (a) kontrata të investimit që kanë formë ligjore të një kontrate sigurimi, por që nuk e ekspozojnë siguruesin ndaj rrezikut të rëndësishëm të sigurimit, për shembull, kontratat e sigurimit të jetës në të cilat siguruesi nuk mbart rrezik të rëndësishëm mortaliteti (të tilla kontrata janë instrumenta financiarë jo-sigurimi ose kontrata shërbimi, shih paragrafët B20 dhe B21).
- (b) kontratat që kanë formë ligjore të sigurimit, por që kalojnë të gjithë rrezikun e rëndësishëm të sigurimit tek mbajtësi i policës së sigurimit nëpërmjet mekanizmave të paanulueshëm dhe detyrues, që rregullojnë pagesat e ardhshme të mbajtësit të polëcës së sigurimit si një rezultat direkt i humbjeve të siguruar, për shembull, disa kontrata financiare risigurimi ose disa grupe kontratash (të tilla kontrata janë zakonisht instrumenta financiarë jo-sigurimi ose kontrata shërbimi, shih paragrafët B20 dhe B21).
- (c) vetë-sigurimi, me fjalë të tjera, mbajtja e një rreziku që mund të ishte mbuluar nga sigurimi (nuk ka kontratë sigurimi sepse nuk ka marrëveshje me palën tjetër).
- (d) kontrata (të tilla si kontratat e lojrave të fatit) që kërkojnë një pagesë nëse ndodh një ngjarje e pasigurt e caktuar, por nuk kërkojnë që ngjarja të ndikojë negativisht mbajtësin e policës së sigurimit si një parakusht për pagesën. Megjithatë kjo nuk ndalon specifikimin e një pagese të paracaktuar për të përcaktuar në mënyrë sasiore humbjen e shkaktuar nga një ngjarje e caktuar e tillë si, vdekja ose një aksident (shih gjithashtu paragrafin B13).
- (e) derivativët që ekspozojnë një palë ndaj rrezikut financiar por jo ndaj rrezikut të sigurimit, sepse ata kërkojnë që pala të bëjë pagesa bazuar vetëm në ndryshimet në një ose më shumë variabla si, norma interesi të caktuara, çmimi i instrumentave financiarë, çmimi i mallrave, norma e kurseve të këmbimit, indeksi i çmimeve, klasifikimi i kredisë ose indeksi i kredisë apo variabla të tjerë, nëse në rastin e një variabli jo-financiar ky varibël nuk është specifik për një palë të kontratës (shih SNK 39).
- (f) një garanci e lidhur me kredinë (ose letër kredija, kontratat e kredisë së derivativit të mospagimit ose kontratat e sigurimit të kredisë) që kërkojnë pagesa edhe nëse mbajtësi nuk ka pësuar një humbje nga dështimi i debitorit për të bërë pagesat kur ato kërkohen (shih SNK 39).
- (g) kontrata që kërkojnë një pagesë bazuar në ndryshimet në variblat klimaterikë, gjeologjikë ose varibla të tjerë fizikë, të cilët nuk janë specifike për një palë në kontratë (zakonisht të përshkruara si derivativë të motit).
- (h) obligacionet katastrofë që ofrojnë pagesa të pakësuar të principalit, interesit ose të të dyjve, bazuar në një variabël klimaterik, gjeologjik ose variabël tjetër fizik, i cili nuk është specifik për një palë të kontratës.

B20 Nëse kontratat e përshkruara në paragrafin B19 krijojnë aktive financiare ose pasive financiare, ato janë brenda objektit të SNK 39. Ndër të tjera, kjo do të thotë se palët e kontratës përdorin atë që ndonjëherë quhet kontabiliteti depozitë, që përfshin sa vijon:

- (a) një palë njih shumën e marrë si një pasiv financiar, dhe jo si të ardhur.
- (b) pala tjetër njih shumën e paguar si një aktiv financiar, dhe jo si një shpenzim.

B21 Nëse kontratat e përshkruara në paragrafin B19 nuk krijojnë aktive financiare ose pasive financiare, zbatohet SNK 18. Sipas SNK 18, të ardhurat e lidhura me një transaksion që përfshin kryerjen e shërbimeve, njihen duke ju referuar fazës së përfundimit të transaksionit, kur rezultati i transaksionit mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Rreziku i rëndësishëm i sigurimit

- B22 Një kontratë është një kontratë sigurimi vetëm nëse ajo transferon rrezik të rëndësishëm sigurimi. Paragrafët B8-B21 trajtojnë rrezikun e sigurimit. Paragrafët në vijim trajtojnë vlerësimin e faktin nëse rreziku i sigurimit është i rëndësishëm.
- B23 Rreziku i sigurimit është i rëndësishëm nëse dhe vetëm nëse një ngjarje e siguruar mund të shkaktojë që një sigures të paguajë përfitime shtesë të rëndësishme në ndonjë situatë, me përjashtim të situatave që nuk kanë thelb tregtar (d.m.th. nuk ka efekt të dukshëm në ekonominë e transaksionit). Nëse përfitimet shtesë të rëndësishme do të ishin të pagueshme në situata që kanë përmbajtje tregëtare, kushti në fjalinë e mëparëshme mund të plotësohet edhe nëse ngjarja e siguruar ka shumë pak mundësi, ose edhe nëse vlera aktuale e pritshme (d.m.th. probabiliteti i ponderuar) e flukseve të mjeteve monetare të kushtëzuara, është një pjesë e vogël e vlerës aktuale të pritshme të të gjitha flukseve të mbetura kontraktuale.
- B24 Përfitimet shtesë të përshkruara në paragrafin B23 i referohen shumave që tejkalojnë ato që mund të jenë të pagueshme, nëse nuk do të ndodhte ngjarja e siguruar (duke përjashtuar situatat që nuk kanë përmbajtje tregëtare). Këto shuma shtesë përfshijnë kostot e trajtimit dhe të vlerësimit të kërkesave, por përjashtojnë:
- (a) humbjen e aftësisë për t'i ngarkuar mbajtësit e policës së sigurimit për shërbimet e ardhshme. Për shembull, në një kontratë sigurimi jete të lidhur me investime, vdekja e mbajtësit të policës së sigurimit do të thotë se siguresi nuk mund të vazhdojë të kryejë shërbimet e menaxhimit të investimit dhe të grumbullimit të një komisioni për të bërë këtë. Megjithatë, kjo humbje ekonomike për siguresin nuk pasqyron rrezikun e sigurimit njëloj sikur një manaxher i fondeve të përbashkëta nuk ndërmer rrezik sigurimi lidhur me vdekjen e mundshme të klientit. Prandaj humbja e mundshme e komisioneve të ardhshme të menaxhimit të investimeve nuk është e rëndësishme në vlerësimin se sa shumë rrezik sigurimi transferohet nga një kontratë.
 - (b) me vdekjen heqja dorë nga detyrimet që mund të ishte bërë në anullim ose dorëzim. Për shkak se kontrata solli krijimin e këtyre detyrimeve, heqja dorë nga këto detyrime nuk kompenson mbajtësin e policës së sigurimit për një rrezik para-ekzistues. Prandaj ato nuk janë të rëndësishëm në vlerësimin sesa rrezik sigurimi tranferohet nga një kontratë.
 - (c) një pagesë e kushtëzuar në një ngjarje e cila nuk i shkakton një humbje të rëndësishme mbajtësit të kontratës. Për shembull, merrni në konsideratë një kontratë, e cila kërkon që lëshuesi të paguajë një milion njësi monetare nëse një aktiv pëson një dëmtim fizik duke shkaktuar një humbje të parëndësishme ekonomike të një njësie monetare të mbajtësit. Në këtë kontratë, mbajtësi transferon tek siguresi rrezikun e parëndësishëm të humbjes së një njësie monetare. Në të njëjtën kohë, kontrata krijon rrezik jo-sigurimi, që siguresi do të duhet të paguajë 999,999 njësi monetare nëse ndodh ngjarja e specifikuar. Për shkak se lëshuesi nuk pranon rrezik të rëndësishëm të sigurimit nga mbajtësi, kjo kontratë nuk është një kontratë sigurimi.
 - (d) rikuperime të mundshme të risigurimit. Siguresi i trajton këto veças.
- B25 Një sigures duhet të vlerësojë rëndësinë e rrezikut të sigurimit kontratë për kontratë, dhe jo duke ju referuar materialitetit të pasqyrave financiare⁶. Prandaj rreziku i sigurimit mund të jetë i rëndësishëm edhe nëse ka një probabilitet minimal të humbjeve materiale për të gjitha kontratat. Ky vlerësim kontratë-për-kontratë lehtëson klasifikimin e një kontrate si një kontratë sigurimi. Megjithatë nëse një grup relativisht homogjen kontratash të vogla njihet se përbëhet nga kontrata që të gjitha transferojnë rrezik sigurimi, një sigures nuk ka nevojë të analizojë çdo kontratë brenda këtij grupi për të identifikuar disa kontrata jo-derivative, të cilat transferojnë rrezik të parëndësishëm sigurimi.
- B26 Nga paragrafët B23-B25 vijon se nëse një kontratë paguan një përfitim për vdekje, që tejkalon shumë e pagueshme në mbijetesë, kontrata është një kontratë sigurimi me përjashtim të rastit, kur përfitimi shtesë për vdekjen është i parëndësishëm (i gjykuar duke ju referuar kontratës dhe jo një grupi të tërë kontratash). Siç vihet në dukje në paragrafin B24(b), me vdekjen, heqja dorë nga anullimi ose dorëzimi i detyrimit nuk përfshihet në këtë vlerësim, nëse kjo heqje dorë nuk kompenson mbajtësin e policës së sigurimit për një rrezik para-ekzistues. Në mënyrë të ngjashme një kontrate e përvitshme që paguan shumën të rregullta për jetën e mbetur të mbajtësit të policës së sigurimit është një kontratë sigurimi, me përjashtim të rastit kur pagesat e bashkuara të kushtëzuara për sigurimin e jetës janë të parëndësishme.
- B27 Paragrafi B23 i referohet përfitimeve shtesë. Këto përfitime shtesë mund të përfshijnë një kërkesë për të paguar përfitimet më herët nëse ngjarja e siguruar ndodh më herët dhe pagesa nuk rregullohet për vlerën në kohë të parasë. Një shembull është sigurimi i plotë për jetën për një shumë fikse (me fjalë të tjera, sigurimet që ofrojnë një përfitim për vdekjen të fiksuar, pavarësisht se kur vdes mbajtësi i policës së sigurimit, pa datë skadimi për

⁶ Për këtë qëllim, kontratat e nëshkruara njëkohësisht me palën tjetër (ose kontratat te cilat janë te ndërvarrura) nga një kontratë e vetme.

mbulimin). Është e sigurt se mbajtësi i policës së sigurimit do të vdesë, por data se kur do të ndodhë nuk është e sigurt. Siguruesi do të pësojë një humbje për ato kontrata individuale në të cilat mbajtësi i policës së sigurimit vdes më herët, edhe nëse nuk ka një humbje të përgjithëshme për të gjithë grupin e kontratave.

- B28 Nëse një kontratë sigurimi është e veçuar në përbërësin depozitë dhe në përbërësin sigurim, rëndësia e transferimit të rrezikut të sigurimit vlerësohet duke ju referuar përbërësit sigurim. Rëndësia e rrezikut të sigurimit të transferuar nga një derivativ i përfshirë vlerësohet duke ju referuar derivativit të përfshirë.

Ndryshimet në nivelin e rrezikut të sigurimit

- B29 Disa kontrata nuk transferojnë ndonjë rrezik sigurimi tek lëshuesi që në fillim, megjithëse transferojnë rrezik sigurimi në një moment të dytë. Për shembull, merrni në konsideratë një kontratë që siguron një kthim të caktuar nga investimi dhe përfshin një opsion për mbajtësin e policës së sigurimit për të përdorur të ardhurat e investimit në maturim, për të blerë një kontratë sigurimi të përvitshme jete të kushtëzuar me normat aktuale të të përvitshme të përdorura nga siguruesi për përfitues të tjerë të rinj, nëse mbajtësi i policës së sigurimit ushtron opsionin. Kontrata nuk transferon rrezik sigurimi tek lëshuesi derisa të ushtrohet opsioni, për shkak se siguruesi është i lirë të çmojë të përvitshmen mbi një bazë që pasqyron rrezikun e sigurimit të transferuar tek siguruesi në atë kohë. Megjithatë, nëse kontrata specifikon normat e të përvitshmes (ose një bazë për vendosjen e normave të të përvitshmes), kontrata transferon rrezik sigurimi tek nxjerrësi që në krijim.
- B30 Një kontratë që kualifikohet si një kontratë sigurimi mbetet një kontratë sigurimi derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet të shlyhen ose skadojnë.